

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“K.H.D” Sh.p.k

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare", ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR", sot me date 20 Janar 2023 me vullnetin e lire e te plote vendosemi te krijojme dhe miratojme statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "K.H.D" sh.p.k, me kete permbajlje,

I.-DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 20.01.2023 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjislacionit Shqiptar, kryesisht ne ligjin nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi, ka perpiluar dhe nenshkruar statutin e Shoqerise si me poshte vijon :

Neni 1-Forma

Shoqeria "K.H.D" sh.p.k eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjislacioni ne fuqi.

Ky statut eshte perpiluar ne perputhje me legjislacionin shqiptare dhe ka karakter te detyrueshem per nenshkruarit e tij, ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, plotesohen nga legjislacioni shqiptare.

Shoqeria me pergjegjesi te Kufizuar "K.H.D " Sh.p.k, krijohet nga ortakët e saj,

- **Znj.Klesa Murati** e identifikuar me Pasaport nr.BB1029789 dhe me nr.Indentifikimi personal K46023075A, e bija Mitat, e datelindjes 23.10.2004, banues ne Lagja "çlirimi",Pallati sheditorja e palemave Lushnje.
- **Znj.Leonida Kuqi** e identifikuar me Kart Identiteti nr.035828482 dhe me nr.Indentifikimi personal J45423016V, e bija Luan, e datelindjes 23.04.1994, banuese ne Ballagat te rrethit Lushnje.

Neni 2 – Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte "K.H.D" Sh.p.k.

Neni 3 - Selia

Shoqeria "K.H.D" sh.p.k, e ka seline ne adresen: "Jazexhias",Njesia Administrative Ballagat,Zona kadastrale 2001,me numer pasurie 244/11,Rrethi Lushnje.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete mbi 10(dhjete) vjet. Ky afat mund te zgjatet me vendim te ortakëve te saj themelues ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

II.-OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise "K.H.D" Sh.p.k do te jete kryesisht ne fushen : Grumbullimi i ullinjve,perpunimi, prodhimi i vajit te ullirit,shitje dhe tregtim te vajit te ullirit,brenda dhe jashte vendit.Import-Eksport i makinerive dhe paisjeve qe jane ne funksjone te fabrikes se vajit dhe cdo makinerie tjeter qe eshte ne funksjon te agrobiznesit.Si dhe cdo aktivitet tjeter ne fushen e agrobiznesit qe konsiderohet fitimprures dhe ne interes te shoqerise. Shoqeria mund te kryej cdo veprimtari tjeter qe eshte e lejuar nga ligji.

Neni 6

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te Ortakëve te saj.

Neni 7

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te krijojë filial, dege e perfaqesi brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve ku do te ushtrroje veprimtarine.

Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit. Per detyrimet e veta Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj.

III-MJETET E SHOQERISE

Neni 9

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren **100 000 (Njeqindemije) Leke**. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne nje kuote sipas pjesemarrjes ne pergjindje per secilin ortak.

Kapitali themellar i shoqerise zoterohet si me poshte :

- **Znj.Klesa Murati** Me cilesine e ortakut themelues zoteron nje kuote e barabart me vleren 50 000 leke (Pesdhjetemije).
- **Znj.Leonida Kuqi** Me cilesine e ortakut themelues zoteron nje kuote e barabart me vleren 50 000 leke (Pesdhjetemije).

Neni 10

Kapitali i Shoqerise mund te shtohet me vendim te ortakeve te saj, vendim i cili duhet te depozitohet ne zyren perkatese. Aktiviteti ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket te kene te drejta pronesie dhe aktivitet jashte kesaj shoqerie.

IV.-ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj duke u bazuar ne kete Statut dhe ne ligjet ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Neni 12

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e saj financiare, me mjete e kredi te akorduara ne menyre te ligjshme. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se vet ta ushtroje ne vartesi te shumes se mjeteve te investuara dhe te shumes se mjeteve te rezervuara.

Neni 13

Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdore ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

Neni 14

Kapitali themellar i shoqerise dhe kapitali i mevonshem mund te krijoje nje fond te vecante , qe mund te mbetet ne llogarine bankare te shoqerise. Fondet monetare te shoqerise do te perdoren ne perputhje me kete statut te shoqerise dhe ligjet ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Shoqeria do te celi llogari ne banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, ne euro, usd e monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ana e ortakeve dhe administratorit e saj.

Neni 16

Shoqeria do te krijoje keto fonde: Fondi Themellar, Fondi Rezerve , Fondi i Shperblimit.Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te krijoje edhe fonde te tjera. Fondi themellar i shoqerise formohet nga Kapitali Themellar si dhe mjetet qe do krijohen gjate aktivitetit ekonomik te saj.

Neni 17

Shoqeria shfrytezon fondin Themellar per ushtrimin e veprimtarise se vet per investime te ndryshme ne interes te realizimit te qellimit te shoqerise, si dhe per te mbuluar rreziqet mbas shfrytezimit te fondit rezerve. Fondin Themellar shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj afariste.

Neni 18

Fondi Rezerve i shoqerise formohet nga nje pjese e fitimit, qe ajo realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Ortakeve te saj. Fondi Rezerve shfrytezohe per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

V.-ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 19

Organet drejtuese te shoqerise:

-Ortaket e shoqerise .

-Administratori i shoqerise do te jete **Z. Shyqyri Hasan Kuqi**, per nje afat 5 (pese) vjet,Me adres banimi: "Jazexhias",Njesia Administrative Ballagat,Zona kadastrale 2001,me numer pasurie 244/11,Rrethi Lushnje.

Neni 20

Ortaket e shoqerise ushtrojne keto funksione : Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit te veprimtarise se shoqerise dhe aktet e pergjithshme, vendime per ndryshimin e emertimit te shoqerise, te cilesise se saj, te objektit te veprimtarise, per shtim ortakesh , ndryshim administrator.

Vendos per rritjen ose pakesimin e kapitalit themeltar te shoqerise, miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar te shoqerise, vendos per ndryshimin e forms se organizimit te shoqerise. Vendos per mbylljen e veprimtarise dhe caktimin e likujdatoreve. Te gjitha keto funksione do te kryhen ne perputhje me ligjin "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per regjistrin tregtar".

Neni 21

Administratori i shoqerise ka keto detyra:

Organizimin e drejtimin e punes dhe veprimtarise se shoqerise, perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet. Mban pergjegjesi per zbatimin e ligjeve ne shoqeri si dhe per aktivitetin ekonomik te saj. Pergatit aktet qe jane kompetence te ortakeve te shoqerise. Merrret me organizimin dhe drejtimin e shoqerise si dhe percakton strukturen, numrin, kualifikimin e punonjesve te shoqerise, perfaqeson shoqerine ne lidhjen e kontratave dhe kryen veprime te tjera juridike qe nuk jane kompetence te ortakut te vetem.

Neni 22

Ne mungese apo ne pamundesi te ushtrimit te funksionit te administratorit ate e zevendeson nje punonjes tjetet, qe caktohet nga ai vete me shkrim.

VI.-MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT.

Neni 23

Pas perballimit te detyrave qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhe shpenzimeve te tjera, fitimi neto i shoqerise qe i perket ortakeve te saj, mund ta perdorin ate lirisht sipas deshires se vet.

VII.-MARREDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA.

Neni 24

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e Themelimit, me kete Statut dhe Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise. Shoqeria lidh kontraten per marrjen ne pune te punonjesve sipas Kodit te Punes.

Neni 25

Punonjesi ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaket, administratori dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive e pervojave se fituar e shkëmbyer ne kuadrin e shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare dhe burimeve te mallrave, identitetin e shumave e te ardhurave te saj, depozitave, te dhena te tjera qe organizimin e orientimin e shoqerise i konsideron sekrete te punes. Te dhenat e punes qe paraqesin sekretet e punes mund te behen te njohura peronave te tjere me lejen e administratorit te shoqerise. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes se marrdhenieve te punes me shoqerine.

VIII.-MBYLLJA E SHOQERISE.

Neni 26

Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te perballohen me mjetet e ortakeve te kesaj shoqerise, te vena me rastin e themelimit te shoqerise, hapet procedura e likujdimit te shoqerise.

Neni 27

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit te shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeria ne likujdim e siper". Ne rast shperndarje te shoqerise, administratori vendos per menyren e likujdimit, ortaket caktojne nje ose disa likujdator, te cilet bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje detyrimet, qe ka ndaj personave te trete.

Neni 28

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten ortakeve te saj.

Neni 29

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Bilanci vjetor i shoqerise duhet te shqyrtohet dhe miratohet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 30

Ne rast vdekje te ortakeve, pasuria e tyre i kalon ne pronesi trashegimtareve ligjor ne perputhje me dispozitat ligjore per trashegimine. Administratori i shoqerise ka te drejte te emeroje avokat dhe ekonomist si dhe t'ju japi te drejta personave te tjere, qe veprojne ne emer dhe per llogari te tij sipas ligjeve ne fuqi.

IX.-DISPOZITAT E FUNDIT.

Neni 31

Shoqëria deklarohet e krijuar me vendimin e Ortakëve të shoqërisë. Nga kjo ditë fiton statusin e Personit Juridik.

Neni 32

Ndryshimet në këtë statut behen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret ky statut duhe zbatuar dispozitat ligjore përkatëse.

Neni 33

Mosmarveshjet në shoqëri do të zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet do të zgjidhen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të qytetit ku i takon.

Neni 34

Ky Statut u përpilua në pesë kopje për të administruar sipas ligjit.

ORTAKET THEMELUES

Klesa Murati



Leonida Kuqi

